



Prania / Presence Prisence / Presence Presence / Presence	28.04.2023	3	viti god year
Organ / Agency Organ / Agency Organ / Agency	In Prok In Prok In Prok	Sistoj / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHKK	3952/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.439/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.439/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi fsh Radivojce, nga Komuna e Vitisë kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.439/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil , i punësuar në Komunën e Vitisë, më datë 01.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2210/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos marrjes së përgjigjes heshtjes administrative nga Komuna e Vitisë, për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5) nga data 01.12.2011 e deri me 27.02.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vitisë. Ndërsa Komuna e Vitisë, me datë 14.04.2023 Komuna e Vitisë ka dërguar përgjigjen në ankesën tek Këshilli.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 439/2023 me numër të protokollit 2210/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 30.12.2011;

Përshkrimi i Detyrave të Punës; Lista e pagave; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3599/2023 e datës 14.04.2013.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se pranë Komunës së Vitisë, ka parashtruar kërkesë lidhur me kompezimin e koeficientit dhe së asnjëherë nuk është trajtuar, po ashtu në ankesën e parashtruar në Këshill ankuesi ka pretenduar për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5) nga data 01.12.2011 e deri me 27.02.2023, nga Komuna e Vitisë.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë kolegji konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, nga se ankuesi nga 01.12.2011 e deri me 27.02.2023, nuk ka parashtruar ankesën dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 01.03.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit ku është përcaktuar koeficienti nga shtatë pikë pesë (7.5), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Rrjedhimisht nisur nga dispozitat e lartshënuar, ankuesi ka humbur afatin, por Kolegji konstaton se nga data 01.12.2011 e deri me 27.02.2023 ankuesi është kompensuar konform akt emërimit të cilin e ka pasur të nënshkruar, dhe i njëjti kompensohet sipas akt emërimit me ndryshime prandaj ankuesi nuk ka asnjë bazë ligjore që të kërkoj kompensimin retroaktive sepse nuk asnjë dëshmi të vetme se i është shkelur e drejta në pagë sipas akt emërimit.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.439/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

